

MJERË MAQEDONIA ME AKADEMIKËT E SAJ!

Nga Xhavit Shala

Jo vetëm segmente të fuqishme të politikës maqedonase, por edhe akademikët e saj po punojnë përditë për ndarjen e Maqedonisë duke nxitur atje urrejtjen ndëretnike, sidomos me shqiptarët autoktonë. Akademikët, kudo në botë, kontribuojnë jo vetëm për shkencën, por dhe për prosperitetin dhe ecjen përpara të kombit e shtetit të tyre, prandaj dhe e meritojnë atë titull. Ndryshe veprojnë këta akademikët e Maqedonisë. Mjerë Maqedonia për akademikët e saj!¹

Në momentet më kritike për vetë Maqedoninë dhe kombin e saj, kur proceset e saj integruese janë stopuar për shkak të konfliktit me Greqinë për çështjen e emrit, kur identiteti i saj kombëtar është vënë në dyshim edhe nga vetë maqedonasit, jo pak prej të cilëve po nxisin të marrin shtetësi bullgare, hidhet në treg Enciklopedia e Maqedonisë, një manifest i flaktë i nacionalizmit maqedonas, botim i përgatitur nga Akademia e Shkencave të Maqedonisë dhe e financuar me fondet e qeverisë Gruevski, pra dhe me paratë e taksapaguesve shqiptarëve atje.

Në atë enciklopedi lexohet se “Shqiptarët në Maqedoni kanë ardhur nga Shqipëria veriore. Ata, kanë kolonizuar viset në Maqedoni në shekullin XVI, duke i dëbuar maqedonasit nga shtëpitë e tyre”; “Vërshimin e tyre drejt Maqedonisë e ka mundësuar Ali Pashë Tepelena. Shteti i parë shqiptar është formuar nga Gjermania fashiste, e cila kufijtë e këtij shteti i zgjeroi në rajonet e Maqedonisë perëndimore. Shqiptarët, veç tjerash, njihen edhe si njerëz malorë...”. Akademikët maqedonas hiqen sikur nuk e dinë se kur është krijuar shteti fqinjë me ta dhe, për më tepër, që ky fqinjë, Shqipëria, është mëmëdheu i rreth 1/3 së shtetasve të Maqedonisë. Mjerë Maqedonia për akademikët e saj!

Shkrime të tilla në Maqedoni, ku shtrembërohen të vërtetat për shqiptarët, ka pasur me shumicë, gjatë gjithë kësaj periudhe kur maqedonasit po kërkojnë e nuk po e gjejnë identitetit e tyre. Por kur ato kalojnë në një stad më të lartë, duke u legalizuar në një enciklopedi zyrtare, situatat duhen vlerësuar seriozisht. Grupi punues i akademikëve maqedonas, nën drejtimin e Bllazhe Ristovskit, ka shpallur tashmë edhe zyrtarisht parimet e qëllimet e veta themelore antishqiptare, duke i dhënë botimit formën e një manifesti nationalist maqedonas.

Ky veprim i Akademisë së Maqedonisë ngjan me Memorandumin që Akademia Serbe e Shkencave botoi më 24 shtator 1986, i cili në të vërtetë ishte manifesti më i flaktë i nacionalizmit serb deri në atë kohë. I trembur nga ai veprim që ndërmori Akademia Serbe e Shkencave, Ivan Stamboliçi, kreu i komunistëve serbë, e quajti në atë kohë memorandumun si nekrologji të Jugosllavisë. Për të, “Jugosllavia është e vetmja zgjidhje e çështjes së serbëve. Pa Jugosllavi, kombi

¹ Shkrimi është botuar në të përditshmen “Shqip”, datë 22 shtator 2009

serb është i dënuar të copëtohet". Dhe Stamboliçi nuk gaboi në parashikimin e tij. Akademikët maqedonas në vend që të nxjerrin mësim nga eksperiencia e hidhur serbe, po kopjojnë në veprimtarinë e tyre nacionaliste rrugën e gabuar të kolegëve të tyre të Akademisë Serbe të Shkencave. Mjerë Maqedonia për këta akademikët e saj!

Botimi i Enciklopedisë së Maqedonisë, në raport me ne shqiptarët si komb, duhet analizuar në dy drejtime kryesore. E para sa janë të vërteta shkencërisht ato çka shkruhen për shqiptarët në atë botim dhe, e dyta, pse ky botim u hodh në treg pikërisht në këto momente kur, për të ardhmen e Maqedonisë, janë shfaqur shumë re të zeza në horizont.

Pohimet e Enciklopedisë Maqedonase për shqiptarët nuk kanë asnjë mbështetje shkencore. Ato janë shtrembërime të qëllimshme të historisë. Shqiptarët në Maqedoni popullojnë kryesisht pjesën perëndimore të vendit. Territorët e tyre janë vazhdimësi tokësore me trevat shqiptare të Republikës së Kosovës dhe me ato të Republikës së Shqipërisë. Në Maqedoni, shqiptarët, parë nga aspekti gjeopolitik, përkatësisht historik, territorial dhe demografik, janë pjesë e një tërësie kombëtare që ka shtrirje territoriale mes deteve Adriatik e Jon, lumit Kalamas, luginës së Moravës Jugore dhe Vardarit. Kjo hapësirë territoriale gjeografike, me ndryshime shumë të vogla, përputhet me territorin që në kohërat antike ka qenë i banuar me fiset ilire si Dardanët, Pajonët, Pellagonët, Mollosët, etj. Pra, pjesa më e madhe e Maqedonisë së sotme, në kohërat antike ka qenë e banuar nga fiset ilire, për të cilën ka shumë dëshmi autentike nga historianë grekë, romakë, bizantinë, etj. Vazhdimësia iliro-shqiptare është dokumentuar qartë edhe para e gjatë pushtimit osman. Këto të vërteta shkencore të pranura dhe ndërkombëtarisht, nuk i di apo nuk dëshiron t'i dije vetëm Bllazhe Ristovski, kryeredaktori i Enciklopedisë së Maqedonisë dhe bashkëpunëtorët e tij. Sa keq! Mjerë Maqedonia për këta akademikët e saj!

Por, kur akademikët e marrë maqedonas kanë guximin të hedhin shtrembërime të historisë dhe shpifje në një enciklopedi zyrtare, pse në shqiptarët duhet të kemi frikë të paktën për të shqiptuar të vërtetën rreth pjesës sonë të kombit e cila gjendet sot brenda kufijve të shtetit të sotëm maqedonas? Dhe kjo e vërtetë është pasqyruar, ndërmjet të tjerave, edhe në statistikat zyrtare osmane të vitit 1912. Sipas tyre, pavarësisht lëvizjeve të mëdha të popullsisë në rajonin e Ballkanit, territorët në Maqedoninë Perëndimore kanë qenë të banuara nga një popullsi me shumicë shqiptare, të përfshirë në dy vilajete, atë të Kosovës, ku përfshihej dhe Shkupi, kryeqyteti i sotëm maqedonas dhe në vilajetin e Manastirit, i cili shtrihej deri në Elbasan. Në statistikat zyrtare osmane pasqyrohet qartë se, në vitin 1912 përqindja e popullsisë shqiptare në Vilajetin e Kosovës ishte 61,4 %, ndërsa në Vilajetin e Manastirit ishte 54,1 %. Pra, në dy vilajetet që përfshinin jo vetëm Maqedoninë Perëndimore, por dhe pjesën më të madhe të Maqedonisë së sotme, shqiptarët përbënin rreth 58% të popullsisë. Kjo shifër është rreth 6% më pak se sa përqindja e popullsisë maqedonase në shtetin e sotëm unitar të Maqedonisë.

Këto të vërteta kërkojnë të manipulojnë akademikët maqedonas. Ata duan të sfumojnë çështjen kombëtare të shqiptarëve atje. Por këtë nuk do të arrijnë dot. Çështja e sotme e pazgjidhur shqiptare në Maqedoni i ka rrënjët në histori. Ajo fillon me Traktatin e Shën Stefanit, nënshkruar në përfundim të luftës Ruso-Turke, të vitit 1878, dhe me Kongresin e Berlinit, të po atij viti, thirrur nga Fuqitë e Mëdha Perëndimore, në përgjigje të Traktatit të Shën Stefanit. Vazhdon më pas me Konferencën e Londrës, të vitit 1913, e cila, ndonëse e njohu Shqipërinë si shtet të pavarur, cënoi rëndë kufijtë e saj, duke shkëputur nga trangu etnik rreth gjysmën e trojeve, përfshirë këtu dhe trojet e sotme shqiptare në Maqedoninë Perëndimore dhe përmbillet me Konferencën e Versajës, të vitit 1919, ku u bë zyrtarizimi i ndarjes përfundimtare të këtyre trojeve nga shteti amë. Trojet shqiptare që, tashmë, përfshihen në Maqedoni, ashtu si dhe Kosova, Çamëria dhe trojet e tjera, iu morën forcërisht Shqipërisë. Këto territore, në përmbushje të marrëveshjeve dhe lëshimeve reciproke të Fuqive të Mëdha të kohës dhe në përputhje me interesat e tyre gjeopolitike iu dhanë aleatëve të tyre ballkanas, fqinjëve tanë.

Pas krijimit të Mbretërisë Serbo-kroato-slllovene e më pas të Jugosllavisë edhe maqedonasit ishin të "burgosur" njëlloj si shqiptarët atje. Por pas shkatërrimit të kësaj mbretërie dhe fillimit të luftës nacionalçlirimtare në Jugosllavi, ndryshe nga shqiptarët, maqedonasit fituan të drejtën të kenë republikën e tyre në kuadrin e Federatës Jugosllave. Më pas në vazhdimësi, sidomos pas vitit 1981, duke ndier frikën nga një rilindje kombëtare e shqiptarëve të Kosovës, autoritetet komuniste të Shkupit filluan një represion të paparë ndaj shqiptarëve të Maqedonisë, sidomos ndaj inteligjencies. Kulmin ky represion e arriti në vitin 1989. Dukej sikur maqedonasit kopjonin në çdo hap të tyre Millosheviçin në veprimet e tij antishqiptare, por duke i thelluar më tepër ato.

Pas shpërbërjes së ish Jugosllavisë dhe pavarësimit të Maqedonisë, kushtetuta e saj e vitit 1991 nuk përfilli realitetin e brendshëm të përbërjes etnike të shtetit, duke u bërë, kështu, gjeneruesi kryesor i krizës në Maqedoni. Ajo ligjëroi konceptin nationalist maqedonas për të krijuar shtetin e pavarur, duke injoruar realitetin faktik të përbërjes etnike të këtij shteti. Karakteri i saj thellësisht nationalist maqedonas cënonte rëndë interesat kombëtare të shqiptarëve. Shkak tjetër kryesor i krizës ishin dhe pabarazia në sferën e jetës publike, mospunësimi i shqiptarëve në administratë, në organet gjyqësore dhe në strukturat e sigurisë. Shteti nacional maqedonas përpiqej të shtrihej në një hapësirë gjeografike, ku thuajse gjysma e popullatës është josllove, nga e cila shqiptarët përbënin zyrtarisht 25,17 % të popullsisë. Një politikë e tillë është identike me politikën e qarqeve nacionaliste serbe, e cila përpiqej të kolonizonte Kosovën.

Maqedonasit kishin bindur veten se shqiptarët janë njëlloj si pakicat e tjera etnike: romët, vllëhtë, turqit, serbët, etj. Pra, edhe shqiptarët llogariteshin në kategorinë "pakicë nacionale", njësoj si ato pakica që nuk kishin ndonjë peshë politike, numerike, kulturore apo ekonomike, dhe që nuk mund të ndikonin në gjeopolitikën e shtetit të sotëm maqedonas. Maqedonasit në pushtet, pavarësisht

nga këmbëngulja e shqiptarëve, përpiqeshin t'i trajtonin të drejtat e shqiptarëve në kuadrin e të drejtave të njeriut dhe jo të të drejtave kombëtare. Qëndrimi maqedonas nuk ndryshoi edhe pas luftës në Kosovë. Klasa politike maqedonase nuk e përktheu drejt sinjalin nga Kosova për respektimin e të drejtave kombëtare të shqiptarëve. Ajo nuk nxori mësim as nga dështimi i politikës antishqiptare të regjimit të Millosheviçit. Edhe pas shpërthimit të konfliktit të armatosur të vitit 2001, qarqet nacionaliste maqedonase synuan për ta zgjidhur krizën përmes luftës së armatosur. Ishte ndërhyrja e faktorit ndërkombëtar ajo që i detyroi, si maqedonasit, ashtu dhe shqiptarët të ulen në tavolinën e bisedimeve dhe të nënshkruajnë marrëveshjen, e cila mori emrin e qytetit ku u nënshkrua, "Marrëveshja e Ohrit".

Edhe akademikët maqedonas në enciklopedinë e tyre të botuar së fundmi, pavarësisht të vërtetave historike dhe autoktonisë së tyre, shqiptarët i paraqesin përsëri njëllor si pakicat e tjera entike si romët, vllehtë, turqit, etj. Ky veprim zyrtar maqedonas në të vërtetë i kundërvihen jo vetëm frymës që u përpoq të përçonte marrëveshja e Ohrit për marrëdhëniet ndëretnike dhe posaçërisht me shqiptarët në Maqedoni, por nuk i kontribuojnë as fqinjësisë me Shqipërinë e Kosovën dhe as frymës së paqes e sigurisë rajonale. Si përfundim, shkrimet për shqiptarët në Enciklopedinë e Maqedonisë nuk kanë asnjë bazë shkencore, janë shtrembërime të historisë me qëllime të caktuara politike.

Por pse ky botim u hodh në treg pikërisht në këto momente, kur politika maqedonase po i shton vetë në horizont retë e zeza për të ardhmen e Maqedonisë? Duket se qarqe të fuqishme politike maqedonase nuk kanë hequr dorë nga synimi për ndarjen e Maqedonisë dhe për këtë po venë në lëvizje edhe Akademinë e tyre të Shkencave. Në të vërtetë nuk është hera e parë që akademikët maqedonas kërkojnë ndarjen e shtetit të tyre. Akademia e Shkencave dhe Arteve e Maqedonisë i habiti të gjithë me propozimin e saj të vitit 2001 për shkëmbimin e territoreve dhe popullatës mes Maqedonisë dhe Shqipërisë. Ky propozim në atë kohë u mbështet edhe nga Lubco Georgievski, sot shtetas bullgar, kryeministri i atëhershëm i Maqedonisë, i Partisë VMRO-DPMNE, parti e cila është sot në pushtet në Maqedoni. Propozimi u kundërshtua nga partitë shqiptare, LSDM, opozita e atëhershme maqedonase dhe faktori ndërkombëtar.

Akademikët maqedonas i druhen faktit se Maqedonia Perëndimore, territori ku banojnë kryesisht shqiptarët, krahasuar me rajonet tjera të Maqedonisë, ka lindshmërinë dhe shtimin natyror më të madh të popullsisë në vend. Edhe pse ky rajon në periudhën 1977-2002 shënoi rënie të dukshme të shkallës së lindjeve nga 28,83 në 15,35 për mijë, përsëri ky rajon merr pjesë në shtimin popullsisë së përgjithshme të Maqedonisë në masën mbi 50%. Duket se akademikët maqedonas mendojnë se, pas disa vitesh, Maqedonia do të bëhet një shtet me më shumë shqiptarë se maqedonas. Prandaj ata duan ndarjen e Maqedonisë, duke lëshuar sa më pak territore. Por, për t'u justifikuar para bashkësisë ndërkombëtare për ndarjen, ata duan të bëjnë fajtorë shqiptarët.

Idetë maqedonase për shtete të pastra etnike në Ballkan bien ndesh me frymën rajonale të integritit euroatlantik dhe nuk gëzojnë mbështetje nga faktori ndërkombëtar. Duket se nxitësit dhe përfituesit e drejtpërdrejtë të kësaj strategjie maqedonase përveç segmenteve të caktuara të politikës maqedonase, momentalisht janë dhe serbët e rusët. Ata duan të krijohet precedenti në Ballkan për ndarje mbi baza etnike. Në këtë mënyrë serbët mund të kërkojnë bashkimin me Republikën Serbska të Bosnjës dhe veriun e Kosovës. Bllazhe Ristovski, kryeredaktori i Enciklopedisë së Maqedonisë, ish bashkëpunëtori i shërbimit sekret të Federatës Jugosllave me pseudonimin "Folkloristi", i bëri kështu shërbimin e tij të fundit shëfave të tij në Beograd. Ndërsa rusët do të gjejnë precedentin për të nxitur fillimisht federalizmin e shteteve fqinjë me të, shtete në të cila ka një popullsi të madhe ruse si Ukraina, etj. Rusët e kanë treguar se nuk vonojnë të shfrytëzojnë precedentin, si në rastin e Gjeorgjisë.

Në të vërtetë, nëse edhe shqiptarët në Maqedoni, do të fitonin plotësisht të drejtat e tyre, ashtu si në Kosovë, do të ishte një hap i rëndësishëm drejt zgjidhjes përfundimtare të çështjes kombëtare shqiptare. Kjo do të çonte drejt përmbyshjes së programit madhor të Rilindjes Kombëtare, program i cili është përfshirë edhe në politikën e sigurisë kombëtare të Republikës së Shqipërisë, përkatësisht në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë, miratuar më ligj të veçantë nga Parlamenti Shqiptar. Por, zgjidhja përfundimtare e çështjes kombëtare shqiptare, në politikën e sigurisë kombëtare të shtetit shqiptar, synohet të arrihet nëpërmjet integritit evropian dhe euroatlantik të vendeve të rajonit si edhe zgjidhjeve që sigurojnë garanci afatgjatë dhe të pranueshme për bashkësinë ndërkombëtare. Megjithatë situata në Maqedoni duhet ndjekur me kujdes. Politikën tona të sigurisë kombëtare, ndonëse nuk e pohojnë, nuk e përjashtojnë përfshirjen e mbarë trojeve shqiptare në një shtet të vetëm kombëtar si zgjidhjen përfundimtare të çështjes kombëtare shqiptare.

Gjithsesi, pavarësisht papërgjegjshmërisë së akademikëve dhe segmenteve të caktuara të politikës maqedonase në raport me shqiptarët, faktori ndërkombëtar nuk besohet se do të lejojë ndarjen e Maqedonisë. Në të kundërtën më të humburit do të ishin vetë maqedonasit, të cilët nuk e kanë përcaktuar akoma identitetin e tyre. Prandaj themi mjerë Maqedonia për akademikët e saj!

NDRYSHET



Medvedev, INC dhe SHBA? Jemi në rrugë të mbarë
NE FAQEN 14-15



Dashmit, si martohen çiftet në Indi
NE FAQEN 18



Traga, aty ku pranvera "çeli" në dimër
NE FAQEN 20



Shqip



Drejtuar **BESHK MUSTAFI**
Kryeredaktor **OHM BARRAMI**

Vite IV - Nr. 262 (1273) | E martë, 22 shtator 2009 | E përditshme e pavarur | Çmimi 80 lekë, 1.5 euro

Adresa e redaksionit:
Rr. Sami Frashëri,
Pallati e Artaçit, Nr. 4
Tirë 04 2 272 065 + 068 20 05 300
E-mail: info@shqip-shqip.com
www.gazeta-shqip.com

Enciklopedia, shqiptarët dalin në shesh: Të zhduket

ENCIKLOPEDIA E POPULLIT DHE E SHITITIT TE TRILLUAR

KIM MEHMETI

Një popull, që ka akademikë si ata që i ka populli i vetëshquar maqedonas, ai popull edhe gjatë kohës do të mbetet i ngatëruar në të kaluarën e vet, po ditur...
NE FAQEN 8



NE FAQEN 11

MJERE MAQEDONIA ME AKADEMIKET E SAJ!

XHAUIT SHALA

Jo vetëm segmente të fuqishme të politikës maqedonase, por edhe akademikët e saj po përuajnë përditë për ndarjen e Maqedonisë, duke rritur atje urrejtjen...
NE FAQEN 8

Bojkoti i PS-së "dëg" ligjet
Kuvendi nuk i ka numrat, bllokohen disa reforma

